



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2020:069067

Datë: 29.11.2023

Numri i dokumentit: 04982238

C.nr.2768/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË FUSHË KOSOVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Freskim Musliu, në çështjen juridike kontestimore të paditëses N. P. nga Fushë Kosova, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. S . K . nga Prishtina, ndaj të paditurës Komuna e Obiliqit - Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit avokati N . M . nga Prishtina, për pagesën e shujtës dhe shpenzimeve të udhëtimit, jashtë seance, me datë 29.11.2023 mori këtë:

AKTGJYKIM

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses N. P. nga Fushë Kosova dhe DETYROHET e paditura Komuna e Obiliqit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses në emër të kompensimit të ushqimit në punë për 702 ditë pune për periudhën nga data 18.04.2017 e deri me datë 08.06.2021, t’ia paguajë shumën prej 1,404.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 22.04.2020 kur është parashtruar padia, e deri në pagesën definitive, dhe atë në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

II. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 702 ditë pune, për periudhën nga data 18.04.2017 e deri me datë 08.06.2021, t’ia paguajë shumën prej 491.4 euro.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m i

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, me datë 22.04.2020, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Obiliqit – Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën e ushqimit gjatë punës, me kamatë ligjore.

Paditësja padinë e saj e ka ndryshuar në aspektin objektiv me parashtruesen e datës 26.07.2023, duke kërkuar edhe shpenzimet e udhëtimit.

Në padi, përkatësisht ndryshimet e padisë, ka theksuar se është në marrëdhënie pune tek e paditura, në SHFMU ‘në Obiliq. Më tutje ka shtuar se paditëses në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit i takon shpërblimi për ushqim gjatë punës nga 2 euro për çdo ditë pune, përkatësisht për 702 ditë pune për periudhën 18.04.2017 – 08.06.2021 në vlerë prej 1,404.00 euro, si dhe shpërblimi për shpenzime të udhëtimit në relacionin Fushë Kosovë – Obiliq. për periudhën e lartcekur në shumë prej 491.4 euro.

Shpenzimet i ka kërkuar, por nuk i ka specifikuar.

E paditura, me datë 28.02.2022 ka parashtruar përgjigje në padi, me të cilën e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar, për arsye se e paditura nuk është nënshkruese e kontratës kolektive në të cilën e bazon kërkesëpadinë paditësja, e rrjedhimisht kjo kontratë nuk mund të ketë implikime financiare për të paditurën, por vetëm për palët nënshkruese. Ka kërkuar që të hedhet poshtë padia e paditëses për shkak se nuk i përmban elementet e domosdoshme të një padie. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, por nuk i ka specifikuar.

Gjykata, pas shqyrtimit të padisë, parashtrësës për ndryshimin e padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe të përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) gjeti se kërkesëpadia e paditëses lidhur me kompensimin e ushqimit në punë është e themeltë, po ashtu gjendja faktike nuk është kontestuese në mes të palëve, andaj pa caktuar seancë fare, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në rastin konkret rezultoi se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja ishte në marrëdhënie pune tek e paditura, në vendin e punës “*Mësuese klase*” në SHFMU ‘në Obiliq. Këtë gjykata e vërtetoi nga kontrata e punës, e datës 04.09.2017, e lidhur në mes të paditëses dhe të paditurës.

Po ashtu, në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja ka qenë prezent në punë nga data 18.04.2017 e deri me datë 08.06.2021 dhe gjithsej ka 702 ditë pune. Kjo u vërtetua nga vërtetimi mbi ditët e pranisë në punë me numër të protokollit 1428/02, i datës 09.06.2021, i lëshuar nga SHFMU ‘në Obiliq.

Fakt tjetër jokontestues ishte edhe fakti se paditësja vendbanimin e ka në Komunën e Fushë Kosovës. Ky fakt u vërtetua edhe nga certifikata e vendbanimit B. . . , e datës 20.07.2023, e lëshuar nga ZGjC në Fushë Kosovë.

Në rastin konkret lidhur me bazën e kërkesëpadisë gjykata vlerëson se duhet të zbatohet Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë (KKAK) e miratuar dhe e nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) me datën 18.04.2017, e cila ka qenë e zbatueshme prej datës së nënshkrimit të saj, e deri me datë 21.01.2021, si dhe për kërkesën për kompensimin e ushqimit në punë pas kësaj date e deri me datë 08.06.2021 duhet të zbatohet Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 22.01.2021 (KKAK).

Neni 2, paragrafi 1 i KKAK-ve përcakton se: *“Dispozitat e Kontratës Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit para universitare (parashkollor, filllore, të mesme të ultë, të mesme të lartë, shkolla speciale dhe qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, [...]”* Ndërsa, paragrafi 2 i të njëjtit nen përcakton se: *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat – DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in, etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës*

Po ashtu, me nenin 35, paragrafi 7 të KKAK-ve, parashihet se *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditës e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore. [...]”*

Në rastin në fjalë gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim t’ia paguajë paditëses kompensimin për ushqimin gjatë punës. Kjo për faktin se ky detyrim është paraparë me nenin 35, paragrafi 7 i KKAK-ve.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kompensimit për ushqimin gjatë punës mori për bazë vërtetimi mbi ditët e pranisë në punë me numër të protokollit 1428/02, i datës 09.06.2021, i lëshuar nga SHFMU ‘në Obiliq, sipas të cilit vërtetim paditësja nga data 18.04.2017 e deri me datë 08.06.2021 gjithsej ka 702 ditë pune, atëherë asaj për 702 ditë pune i takojnë nga dy euro në ditë, pra gjithsej 1,404.00 euro.

Kështu, gjykata nga të gjeturat e cekura më lart e ka detyruar të paditurën që paditëses në emër të kompensimit për ushqimin gjatë punës t’ia kompensojë shumën në lartësi prej 1,404.00 euro.

Ndërsa, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ashtu që e refuzoi si të pabazuar kërkesën e paditëses për kompensim të shpenzimeve të udhëtimit, për faktin se nga gjendja faktike e vërtetuar, u konstatua se paditësja vendbanimin e ka në Fushë Kosovë, dhe rrjedhimisht të njëjtës nuk i takojnë shpenzimet e udhëtimit sipas nenit 35, parag. 5 të KKAK-ve, ku parashihet se *“Punonjësve arsimorë që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*. Kjo për faktin se vendbanimi i paditëses është në Fushë Kosovë, dhe neni i lartcekur u siguron shpenzimet e udhëtimit vetëm punonjësve të arsimit që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë, dhe jo edhe jashtë komunës si në rastin e paditëses nga një komunë në tjetrën, përkatësisht nga Fushë Kosova në Obiliq.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës të parashtruara në përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe si të tilla nuk paraqesin bazë për refuzimin e kërkesës së paditëses, për shkak se e paditura qëndron në detyrimin ndaj paditëses, edhe pse nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit, pasi që në nenin 2 të Kontratës është përcaktuar se kjo kontratë është e zbatueshme edhe për komunat apo DKA-të.

Lartësia e kamatës prej 8%, është përcaktuar në bazë të nenit 382 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së) dhe e njëjta do të llogaritet në shumë e aprovuar nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës, dhe atë duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së, pasi që përfaqësuesi i paditëses nuk i ka specifikuar shpenzimet edhe pse i ka kërkuar, siç parashihet me nenin 463 të LPK-së.

Nga se u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.2768/20, datë 29.11.2023

Gjyqtari
Freskim Musliu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.